



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI – SKUPŠTINA - ASSEMBLY

Legjislatura III

Kryesia e Kuvendit të Kosovës
P-005
Prishtinë, më 17 shkurt 2008, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 17 SHKURT 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku dhe Xhezair Murati.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Lulzim Zeneli dhe Zylfi Merxha;

Kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu;

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Nga NDI-a: Rinor Beka dhe Ian Perkins;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala, dhe

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me Mocionin përmbajtjesor që Kryeministri i Kosovës, së bashku me Presidentin e Kosovës, ia kishin adresuar Kuvendit, me të cilin propozohet të thirrej Seanca e jashtëzakonshme solemne e Kuvendit të Kosovës për të shqyrtuar dy pika të rendit të ditës, si vijon:

1. Deklarata e Pavarësisë, dhe
2. Miratimi i simboleve shtetërore.

Kryetari ftoi Kryetarin e Kosovës ta marrë fjalën.

Kryetari i Kosovës, **Fatmir Sejdiu**, tha se në bashkëpunim me Kryeministrin e Kosovës, Kuvendit ia kanë proceduar një kërkesë të përbashkët, për të pasur një seancë të jashtëzakonshme, në të cilën do të shtrohen këto pika të rëndësishme të rendit të ditës. Meqë Mocioni është i përbashkët, lus Kryeministrin që të vazhdojë me sqarime të mëtejshme.

Kryeministri, **Hashim Thaçi**, tha se ndodhemi në prag të momentit më të rëndësishëm të historisë sonë, në prag të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Tani është koha të marrim vendime, të cilat do ta bëjnë vendin tonë pjesë të kombeve të lira, sovrane dhe të pavarura.

Në përputhje me rregullat procedurale të Kuvendit, kërkojmë nga ju që ta thirrni Kuvendin e Kosovës në seancë të jashtëzakonshme për t'i shqyrtuar këto dy pika të rendit të ditës:

1. Deklarata e Pavarësisë, dhe
2. Miratimi i simboleve shtetërore.

Kryetari hodhi në votim Mocionin për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme solemne. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----të gjithë,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kryesia e Kuvendit, në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, njëzëri

V E N D O S I

Ta thërras Seancën e jashtëzakonshme solemne më 17 shkurt 2008, në orën 15:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Deklarata e Pavarësisë, dhe
2. Miratimi i simboleve shtetërore.

Në vazhdim, **Kryetari** i njoftoi të pranishmit me propozimin për rrjedhën e seancës: për radhën e diskutuesve, kohën e diskutimeve dhe radhën e nënshkrimit të Deklaratës.

Në fund, u konstatua se në orën 13:00 duhet të mbahen mbledhjet e grupeve parlamentare, në të cilat kryetarët e grupeve parlamentare do t'i njoftonin deputetët për rendin e ditës dhe për rrjedhën e seancës së jashtëzakonshme solemne.

Kryetari mbledhjen e deklaroi të mbyllur në orën 12:25.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale